



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:012338

Datë: 19.01.2021

Numri i dokumentit: 01423051

P.nr.1118/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Ylberza Glllogjani, në çështjen penale kundër të pandehurit V. R. nga Fsh., K. për veprën penale **“Vjedhje e pyllit”** nga neni 358 par 2 i KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr. 2019/2015 dt.01.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të dt. 18.11.2020, në prezencë të Prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari, të pandehurit V. R., dhe në mungesë të përf.të të dëmtuarës, me dt. 20.11.2020 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me **18.01.2021** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

V. R., i biri i S. dhe nënës Z., i lindur me dt..... në Fsh., K. ku edhe jeton, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

- Me dt. 03.07.2015 rreth orës 11:25 minuta, në vendin e quajtur, në pyllin e mbrojtur “.....”, i destinuar si Park Kombëtar, me qëllim të vjedhjes i pandehuri ka prerë 13 trupa të llojit “breu” me lartësi prej 15-21 m, me diametër 42-52cm, dhe me vëllim të përgjithshëm prej 13.219m³, me ç\rast Drejtorisë Për Administrimin e Parkut Kombëtar i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 4632.50 Euro.

- Me çka ka kryer veprën penale “Vjedhje e pyllit” nga neni 358 par. 2, i KPRK-së.

- Andaj, gjykata konform nenit 7, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75 par.1, nën par. 1.3, neni 358 par. 2, të KPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

- I.** Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim me gjobë në shumen prej 1000 (njëmijë) euro, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri brenda periudhës një (2) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.
- II.** I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor shumen prej 70 (shtatëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV.** E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr. 2019/2015 dt.01.12.2015, ndaj të pandehurit V. R. nga Fsh., K. për veprën penale “Vjedhje e pyllit” nga neni 358 par 2 i KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me dt.18.11.2020 në të cilën seancë prezantuar prokurori i shtetit Muharrem Bajraktari, i pandehuri V. R. e në mungesë të përf. të dëmtuarës, pasi që përmes telefonit kanë njoftuar gjykatën se nuk do të paraqiten në seancë dhe se propozojnë që seanca të mbahet në mungesë të tyre.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, dhe pasi që i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, gjykata të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pas kësaj i pandehuri V. R. u deklarua se nuk e pranon fajësinë dhe nuk e ndjen veten fajtor.

Pasi që i pandehuri nuk e pranoi fajësinë, seanca vazhdoi me administrimin e provave secilën veç e veç e në lidhmëni reciproke me njëra tjetrën siç janë: deklarimi i dëshmitarit Rr. B., fletë paraqitja e rojtarit të Parkut Kombëtar me nr. 164 dt.02.10.2015, kopja e ditarit të pylltarit e dt.03.07.2015, përshkrimi i aktivitetit të rrojës – kujdestarit në teren R. B., rregullorja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor nr.01/2015 për shërbimet e Agjencisë Për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Institucioneve të saja, rregullorja MMPH nr.01/2015 për kalkulimin e dëmit të shkaktuar, si dhe foto dokumentacioni mbi prerjen Faqe 37,38,39,40 si dhe shkresat tjera të lëndës.

Nga deklarimi i dëshmitarit Rr. B., është lexuar fletë paraqitja e rojtarit të Parkut Kombëtar me nr. 164 dt.02.10.2015 rrjedh se: Në vendin e quajtur me dt.03.07.2015 është hasur i pandehuri V. R. duke tërhequr trupat teknik, ku është bërë matja e që ishin 13 trupa me dimensione 27 deri në 52m2, dhe me vëllim të përgjithshëm prej 13.219m2. - Gjykata si të tillë ia fali besimin pasi që kjo provë gjënë mbështetje edhe në fotot e bëra në vendin e ngjarjes.

Nga fletë paraqitja e rojtarit të Parkut Kombëtar me nr. 164 dt.02.10.2015 rrjedh se i pandehuri V. R., pa leje ka prerë 13 lloje të drurit, të breut, me diametër në cung prej 42-52, me diametër në cm $D=1.3$ (37-47), i mesëm 42.5, lartësi m 15-21, vëllim prej 13.219 m3 e në total prej 13 copë, e me vëllim të përgjithshëm prej 13.219 m3. – gjykata si të tillë, kësaj fletëparaqitja ja fali besimin, për shkak se në mënyrë profesionale dhe të detajuar është specifikuar shkaktimi i dëmit si dhe krahas kësaj të dhënat nga kjo fletë paraqitje janë në përputhshmëri edhe me fotot që janë të bashkangjitura në këtë lëndë penale.

Nga kopja e ditarit të pylltarit e dt.03.07.2015 rrjedh se dëshmitari ditën kritike rreth orë 11:25 minuta ka dal në teren në vendin, e në të cilin vend është hasur i pandehuri V. R. duke tërhequr trupat. – Si të tillë gjykata ia fali besimin.

Nga përshkrimi i aktivitetit të rojës – kujdestarit në teren R. B.rrjedh se i pandehuri V. R. është hasur duke tërhequr trupat në vendin, dhe kjo pas një kontrolli rutinor nga ana e kujdestarit në teren. – Gjykata si të tillë ia fali besimin, pasi që në këtë përshkrim të aktivitetit të rojës – kujdestarit në teren janë përshkruar në detaje të gjeturat nga vendi i ngjarjes.

Nga rregullorja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor nr.01/2015 për shërbimet e Agjencisë Për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Institucioneve të saja rrjedh se i pandehuri ditën kritike ka prerë drunjtë në vendinpa leje. – Si të tillë gjykata ia fali besimin.

Nga rregullorja MMPH nr.01/2015 për kalkulimin e dëmit të shkaktuar rrjedh se i pandehuri ka prerë 13 (trembëdhjetë) drunjtë të llojit Bre në vëllim të përgjithshëm prej 13.219 m3. – si të tillë gjykata ia fali besimin, për faktin se përlllogaritja e demit të shkaktuar është bërë në përputhje me rregulloren e MMPH nr.01/2015.

Nga foto dokumentacioni mbi prerjen faqe 37,38,39,40 si dhe shkresat tjera të lëndës rrjedh se padyshim i pandehuri në vendin e sipërshënuar ka prerë drunjtë pa leje përkatëse.

Pas administrimit të provave materiale i pandehuri dha mbrojtjen e tij ku ndër të tjera deklaroj se: Unë lidhur me këtë rast jam njoftuar pasi që më ka arritur ftesa nga gjykata. Unë asnjë herë nuk e kam takuar Rr. B. në vendin por e kam takuar te proni i cili është larg nga për afërsisht 2 km, dhe aty ka qenë vet i treti. Edhe këtë e kam takuar në vitin 2014, dhe jo në vitin 2015, pasi që në vitin 2015 kam qenë duke punuar në Në atë takim me Rr. B. patëm një konflikt pasi që i njëjti kishte gjuajtur me armë në ajër dhe unë i kam thënë se po i tremb fëmijët dhe pleqtë. Dhe unë ja kam tërheq vërejtjen, pasi që është kufiri afër dhe njerëzit ende kanë frikë. Me të njëjtin jemi shty pak dhe ja kam heqë armën nga dora dhe ja kam jap armën tjetrit pylltar. Më ka qu njerëz për mos me lajmëruar këtë rast në polici dhe unë nuk e kam lajmëruar. Për atë dëshira ime ka qenë që Rr. të jetë këtu që të ia them në sy. Kurrë mua

nuk më ka takuar Rr.. B.as me trupa, dhe e tërë bjeshka jonë është klekë dhe nuk i ka 50m3 dru. Unë asnjë herë nuk e kam kërcënuar Rr. B.. Kam punëtori dhe punoj me zdrukthari, gjatë stinës së dimrit, dhe unë punoj vetëm me mediapan dhe me ivericë dhe jo me dru. Unë dal në Bjeshkë dhe Bjshka jonë është,

Unë them se 90 % gjatë vitit kamë qenë në, dhe besoj që edhe me këtë datë kam qenë në Nuk është e vërtetë që kam prerë drunjtë dhe këto drunjë në foto nuk janë prerë nga ana ime. Në, nëkam punuar në hotel Zambak, dhe aty kam punuar me Mediapan dhe Ivericë. Me R. B. kanë qenë me dy persona dhe sigurisht ishin pylltar, nuk e di sigurte, por ishin edhe dy persona me të.

Pasi që i pandehuri dha mbrojtjen e tij gjykata vazhdoi me marrjen e fjalës përfundimtare të palët të cilët deklaruan se:

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Konsideroj se pas administrimit të provave e sidomos raportit për fletë paraqitje të pylltarit Rr. B.në të cilin raport në mënyrë të detajuar në rubrikat e tij ka pashkruar të gjitha gjetjet ditën kritike, po ashtu në raportin ditor të tij të dt.03.07.2015 përsëri i ka pashkruar veprimet e ditës kritike dhe ka theksuar pamundësinë që ta fotografoj të njëjtin pasi që ka qenë i kërcënuar me pasoja nëse e fotografon, ku pylltari i njëjtë ka fotografuar vetëm trungjet e bëra në llager dhe të tjerat duke i tërhequr ku ka deklaruar se identifikimin e të njëjtit po ashtu e ka bërë nga banorët lokal të atij rajoni, konsideroj se mjaftueshëm u vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale që i vihet në barë. Kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Nuk kam çka të them asgjë, përpos që unë jam i pafajshëm. Gjithmonë jam deklaruar i pafajshëm dhe jam i pafajshëm. Nuk e ndjej vetën fajtor. Nuk kam lidhje me këtë punë. Kërkoj nga gjykata që të më liroj nga aktakuza.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj, pavarësisht mohimeve të vazhdueshme nga ana e tij.

I pandehuri në çdo fazë të procedurës ka mohuar fajësinë, duke aluduar në atë se në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë në Kosovë, por në, dhe me këmbëngulje duke deklaruar se nuk është fajtor, por me asnjë provë, me as një deklaratë nuk arriti ta bindë gjykatën se është i pafajshëm, dhe këtë për faktin që i njëjti deklarimit të tij dhe mohimit kategorikë që nuk është fajtor nuk i bashkëngjiti ndonjë provë e cila do ja krijonte bindjen gjykatës se i njëjti është i pafajshëm.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se për të pandehurin nuk ka asnjë shënim në evidencat e gjykatës se i njëjti është shpallur fajtor për ndonjë vepër penale më parë, pra që do të thotë se i njëjti është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 73 te KPRK-së te pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPRK-se.

Propozimin mbi konfiskimin e masës drunore te propozuar ne aktin akuzues ne kuptim te nenit 115 parag.2 e lidhur me nenin 2.1 të KPRK-ës në vëllim të përgjithshëm prej 13.219m3, të propozuar nga ana e prokurorit të shteti, gjykata si të tillë e vlerësoi por bazu në shkresat e lëndës gjeti se propozimi i tillë është i pa bazuar ngase masa drunore nuk ka dëshmi se është sekuestruar nga organet gjegjëse dhe mbi këtë si e tillë konsideroj se ka mbetur e pa sekuestruar as nga organet e pylltari dhe as nga policia bazu në shkresat e lëndës. Duke qenë nënë pranin e kësaj rrethane, e në mungesë të objektit lëndor për konfiskim gjykata e refuzoi si të paqenë një kërkesë të tillë.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 te KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumën prej 70 (shtatëdhjetë) euro, dhe ne emër te kompensimit te viktimave shumen prej 30 (tridhjetë) euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj ne kontest civil u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së,

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.1118/16, dt. 18.01.2021**

Zyrtarja ligjore

Ylberza Glllogjani

GJYQTARI,

Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:012338
Datë: 19.01.2021
Numri i dokumentit: 01423051